

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Kanë kaluar mbi 5 muaj dhe kuzhina është përgjysmë"/ Denoncimi ndaj "Luna Home" për punimet e papërfunduara
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1394183.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 21:14:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	25 shtator 2026, 21:06:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 25 shtator 2026, 21:05:00 UTC → 25 shtator 2026, 21:07:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t'ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7be2aa94ca0359930947d02a59e4e9693dbb51f3508b286faeb9836067d37ca1
TEKSTI	af2f717438d0c5121ec3cbd736c3a3bbc2e857dbb1e7e878de48573db82c5b80
PAMJA	70d2fde3ff5c634c5c008b73616887fcc7ed489c31a4b66e515f3657d5622ca

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	16bbb19be03c19c7def48313c7505db3de687e67704a059ca8f7744c561641e5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6df622084e2aa16fa426f4c8614ee06bfd4531cb8fc83f4931cef87e966f1ea1
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/16bbb19be03c19c7def48313c7505db3de687e67704a059ca8f7744c561641e5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

“Kanë kaluar mbi 5 muaj dhe kuzhina është përgjysmë”/ Denoncimi ndaj “Luna Home” për punimet e papërfunduara

Shkruar nga: Y Pepa | Publikuar më: 25.09.2026, 23:06



Share



Share



Një qytetar nga Durrësi i është drejtuar redaksisë së JOQ Albania me një denoncim ndaj kompanisë së mobiljeve “Luna Home”, duke pretenduar se ka paguar 1.2 milionë lekë të vjetra për një kuzhinë, por pas më shumë se 5 muajsh punimet nuk janë përfunduar.

Sipas denoncuesit, matjet e kuzhinës janë bërë më 13 prill, ndërsa vlera totale e porosisë ishte 1.6 milionë lekë të vjetra, me një çmim prej 400 mijë lekësh të vjetra për metër linear. Ai thotë se ka paguar paraprakisht 1.2 milionë lekë të vjetra.

Qytetari pretendon se gjatë muajve në vijim ka pasur komunikime të vazhdueshme me kompaninë për përfundimin e porosisë, por afatet janë shtyrë disa herë. Nga komunikimet e dëguara në redaksi shihen mesazhe ku palët diskutojnë për data dhe orare të ndryshme për dorëzimin e pjesëve të mbetura.

Sipas tij, kuzhina është montuar vetëm pjesërisht. Në fotot e dëguara në redaksi dallohet struktura e mobiljeve, ndërsa mungojnë dyert/kapakët e dollapëve, disa panele të sirtarëve dhe pjesë të tjera përfundimtare të kuzhinës.


Në një prej komunikimeve, qytetari kërkon që, nëse pjesët e mbetura nuk mund të përfundojnë, t’i jepet një zgjidhje alternative, duke përfshirë produkte të tjera nga showroom-i. Në biseda diskutohen edhe kapakët e kuzhinës dhe një divan i publikuar nga kompania.

Denoncuesi pretendon gjithashtu se ka tentuar të kontaktojë disa herë me përfaqësuesin e kompanisë dhe se komunikimi ka qenë i vështirë, duke përmendur telefonata pa përgjigje dhe bllokime të numrave.

Ai e cilëson rastin si mashtrim, por ky është pretendimi i tij dhe përgjegjësia përfundimtare lidhur me përmbushjen e porosisë dhe çdo detyrim të mundshëm ligjor kërkon verifikim.

Qytetari thotë se i ka dërguar JOQ Albania komunikimet, fotot dhe materialet e tjera që disponon dhe kërkon që rasti të bëhet publik, duke kërkuar një zgjidhje për kuzhinën ose kthimin e shumës së paguar.

JOQ Albania publikon denoncimin dhe provat e dëguara nga qytetari, ndërsa mbetet e hapur për reagimin dhe sqarimin e kompanisë “Luna Home” lidhur me pretendimet e ngritura.



Më të Lexuarat



Albania për
Media
Etike

ARTIKULL JOETIK?



[View this post on Instagram](#)



A post shared by JOQ News (@joqnews)

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.